

UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E KONTRAKTORËVE

Ky Udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë që kanë përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Ky Udhëzues duhet të përdoret si një ndihmë për të menaxhuar kontraktorët për të arritur punë të kontraktuar pa incidente.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,
Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate*

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI	1
HAPI 1 (VLERËSIMI PARAPRAK I KONTRAKTORIT)	2
HAPI 2 (NDËRVEPRIMI, DHËNJA E KONTRATËS)	3
HAPI 3 (KONTROLLI I PLOTË PARAPRAK NGA KONTRAKTORI)	3
HAPI 4 (KONTROLLI I RASTËSISHËM PARAPRAK I KLIENTIT).....	4
HAPI 5 (MONITORIMI I PUNËS NGA KLIENTI)	5
HAPI 6 (PËRFUNDIMI I SIGURT I PUNËS).....	5
HAPI 7 (RAPORTI I PERFORMANCËS SË KONTRAKTORIT).....	6
HAPI 8 (ARKIVIMI I DOKUMENTEVE)	6
AUDITIMET	7
VËREJTJE PËRFUNDIMTARE.....	7
SHTOJCA: PËRMBLEDHJE	8



HYRJE

Si punëdhënës dhe si pjesë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë (në tekstin e mëtejshëm “SHS”) brenda biznesit tuaj, ju keni një përgjegjësi për të mbrojtur punëtorët, kontraktorët dhe asetet e juaja nga dëmtimi/humbja gjatë punës. Si pjesë e kësaj përgjegjësie, do t'u kërkohet të menaxhoni kontraktorët tuaj me kujdes për të ekzekutuar dhe arritur punën e kontraktuar pa ndonjë incident.

Kontraktori është një punëtor i angazhuar nga i cili kërkohet të kryej një punë të caktuar. Kontraktorët mund të ballafaqohen me shumë rreziqe shtesë të SHS-së në operacionet tuaja nga faktorë të tillë si mosnjohja me vendpunimit të klientit, mospërshtatja me sistemet e menaxhimit të SHS-së së klientit, mungesa e komunikimit, paaftësia dhe mungesa e monitorimit nga klienti (kjo listë nuk është përfundimtare).

FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky dokument udhëzues zbatohet për të gjithë kontraktorët afatmesëm dhe afatgjatë të cilët do të punojnë në vendpunimet/asetet e klientit me aspekte të rëndësishme të shëndetit dhe sigurisë. Kontraktorët afatshkurtër dhe të gjithë konsulentët/trajnerët/profesionistët tjerë të ngjashëm që punojnë vetëm në mjedisin e zyrës përjashtohen nga kjo kërkesë, përveç nëse klienti vendos të zbatojë disa dispozita të këtij udhëzuesi mbi baza përzgjedhëse edhe për kontraktuesit afatshkurtër me rrezik të lartë. Ky dokument bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare.

- **Kontrata afatshkurtër:**

Kohëzgjatja e punës: 1 deri në 30 ditë. Sidoqoftë, punët potencialisht me rrezik të lartë siç përcaktohet nga Matrica e Rrezikut të Shëndetit dhe Sigurisë së Klientit duhet të vlerësohen pavarësisht nga kohëzgjatja e kontratës sipas kriterëve të caktuar.

- **Kontrata afatmesme:**

Kohëzgjatja e punës: 30 ditë deri në 3 muaj.

- **Kontrata afatgjatë:**

Kohëzgjatja e punës: më shumë se 3 muaj.

Ky Udhëzues sugjeron fuqimisht menaxhimin sistematik të të gjithë kontraktorëve, me theks të veçantë tek kontraktuesit afatmesëm dhe afatgjatë, siç shpjegohet në pjesët vijuese.

Edhe përdoruesit kanë mundësi të zgjedhin dhe të përdorin cilindo kombinim sipas nevojave të tyre, rekomandohen hapat e mëposhtëm:



HAPI 1 (VLERËSIMI PARAPRAK I KONTRAKTORIT)

Klienti duhet të vlerësojë një kontraktor në bazë të kriterëve subjektive/të cilësisë/masës së SHS-së bazuar në rreziqet e SHS-së së projektit, para se ata të angazhohen në punë.

Të gjitha aspektet e punës që kontraktori do të kryej, duhet të identifikohen. Duhet të merren parasysh të gjitha implikimet e SS-në në punë. Menaxheri i Departamentit që inicion kontratën emëron Personin e ngarkuar për SHS-në e klientit, i cili do të jetë pika qendrore për shkëmbimin e informacionit, vlerësimin e shëndetit dhe sigurisë gjatë tenderit dhe përgjegjës për performancën e caktuar të sigurisë së kontraktorit dhe administrimin e plotë të ndërveprimit gjatë kohës që kontraktori është në ambientet e klientit, përfshirë edhe përfundimin punës në mënyrë të sigurt. Personi i ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit nganjëherë referohet edhe si Përfaqësues i Klientit për SHS (siç mund të jetë në takime, etj.). Personi i ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit dhe përgjegjësi i punëve teknike mund të jenë i njëjti person ose persona të ndryshëm, varësisht nga trajnimi/përgjegjësia për SHS-në e personit në fjalë. Departamenti qendror i shëndetit dhe sigurisë i organizatës së klientit ofron mbështetje sa herë që departamenti iniciues ka nevojë për të.

Metodat subjektive/të cilësisë për vlerësimin e një kontraktori gjatë tenderimit mund të përfshijnë:

1. Thjesht duke kërkuar certifikata të sistemit të menaxhimit të SHS-së (p.sh., ISO 45001:2018, DuPont, NSCA, Harta e Sigurisë, NOSA, ISRS dhe 5*)
2. Intervista me personelin kryesor për SHS-në e kontraktorëve
3. Rishikimi i performancës së sigurisë së kontraktorëve gjatë 3 viteve të fundit
4. Rishikimi dhe auditimi i sistemit të menaxhimit të SHS-së së kontraktorit.



Kontrollet e mëposhtme, bazuar në rrezikun dhe madhësinë e projektit, duhet të merren parasysh (kjo listë nuk është shteruese):

- Politikat e Shëndetit dhe Sigurisë (PSHS)
- Procedura dhe formularët e raportimit të incidenteve të SHS
- Dokumenti i Sistemit të Menaxhimit të SHS-së së Kontraktorit
- Identifikimi i rrezikut dhe aftësia e vlerësimit të rrezikut
- Diagrami i SHS-së së Organizatës dhe Përgjegjësitë e Organizatës
- Programi i trajnimit/ndërgjegjësimit/aftësimit për SHS-në
- Programi i auditimit dhe vetë-inspektimit të SHS-së përfshirë formularët
- Procedura e rishikimit të menaxhimit të SHS-së
- Gatishmëria emergjente
- Buxheti i SHS-së për projektin
- Çdo kontroll tjetër që mund të caktoj klienti (Shënim: përdorni listën nëse kontraktori ka 5 ose më shumë persona në organizatën e tyre).



Personi i ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë i Kontraktorit është personi kryesor kontaktues/person i caktuar nga ofertuesi/kontraktori të cilin kompania kontraktuese e emëron zyrtarisht dhe me të cilin personi i ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit do të ndërveprojë në faza të ndryshme. Ai/ajo gjithashtu mund të referohet edhe si përfaqësuesi i kontraktorit.

HAPI 2 (NDËRVEPRIMI, DHËNJJA E KONTRATËS)

Kjo fazë siguron që të dyja palët janë në linjë me respektimin e pritjeve të klientëve në fushën e SHS-së dhe që ekziston një gatishmëri e sistemit për kontraktorin e zgjedhur për një performancë të sigurt.

Personi i ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit ofron sqarime të mëtejshme mbi politikat, procedurat, listat e kontrollit, kërkesat për trajnime lokale etj., për personin përgjegjës për SHS-në e Kontraktorit në mënyrë që të dyja palët të jenë në përputhje të plotë me pritjet, kërkesat, politikat, procedurat, metodat, listat e kontrollit etj.

Bëni kontrole të mëtejshme mbi rreziqet nga puna e njëri-tjetrit që mund të ndikojnë në SHS-në e fuqisë punëtore ose dikujt tjetër. Zgjidhni problemet e komunikimit/gjuhës, nëse ka tilla.



HAPI 3 (KONTROLLI I PLOTË PARAPRAK NGA KONTRAKTORI)

Kontraktori duhet të jetë në përputhje me kërkesat e klientit në lidhje me njerëzit, materialet, mjetet, pajisjet, duket raportuar tek personi i ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit.

- Një kontroll i plotë nga kontraktori në fund.
- Zëvendësimi i burimeve të dëmtuara apo atyre nën standardet e caktuara.
- Dorëzimi tek klienti i raporteve të inspektimit të pajisjeve para-përdorimit për gjësendet kryesore dhe për burimet e tjera të identifikuara.





Shembuj:

Njerëzit: Certifikata mbi aftësimin dhe përvojën; certifikata shëndetësore; nën-kontraktorët dhe kompetencat e tyre.

Materiale, vegla, mjete, pajisje: (sipas qëllimit) automjete, ekskavatorë, prerës me gaz, makina saldimi, makina rrotulluese dhe goditëse dhe pajisje tjera me rëndësi; kalibrimi i instrumenteve për testimin e presionit. PMP-të (pajisjet mbrojtëse personale), siç janë pajisjet për parandalimin e rënies, aparatet personale për frymëmarrje, etj.


Familjarizohuni me vendpunimin: Të gjithë punëtorët e kontraktorit kalojnë nëpër vendpunime me personin e ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit për të vërejtur nëse ka rreziqe gjeografike.

HAPI 4 (KONTROLLI I RASTËSISHËM PARAPRAK I KLIENTIT)

Klienti kryen kontrole të rastësishme mbi cilësinë e njerëzve, materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të kontraktorit, duke kërkuar shpjegime nga kontraktori për çdo devijim të gjetur.

Sa i përket rreziqeve të përfshira në natyrën e vendeve të punës, një kontroll paraprak i rastësishëm bëhet nga ana e klientit në burimet e kontraktuesit.

- Intervista të rastësishme të mbikëqyrësve kryesorë të kontraktorëve.
- Inspektimi i ndërtimit të vendpunimit të kontraktorit.
- Kontrollimi i tërë personelit të angazhuar sipas kontratës, për të vërtetuar nëse janë të pajisur me PMP-të e nevojshme.
- Kontrollimi për të vërtetuar nëse kontraktori është i njoftuar me kushtet (përfshirë ato emergjente), kur duhet të ndalet puna, dhe gjithashtu kushtet rreth vlerësimit të zonave të sigurta për njerëzit.





HAPI 5 (MONITORIMI I PUNËS NGA KLIENTI)

Personi i ngarkuar për SHS-në e klientit organizon vizita formale periodike dhe të rastësishme të përfaqësuesve të klientit në vendin e punës të kontraktorit për vëzhgim të sigurisë, për të kryer ndërveprime, monitoruar progresin e punës, vlerësimin dhe zgjidhjen e problemeve të SHS-së. Takimet e rishikimit janë gjithashtu mekanizma të monitorimit.

- Rishikimi i raporteve të vetë-inspektimit dhe auditimit të kontraktorit.
- Auditime të planifikuara dhe të rastësishme të punës së kontraktorit nga ana e klientit.
- Rishikimi i diskutimeve grupore në lidhje me shëndetin dhe sigurinë.
- Rishikimi i raportimit të incidentit nga kontraktori dhe veprimet e ndërmarra korrigjuese/parandaluese.
- Mirëmbajtja e vendpunimit.
- Një monitorim i tillë ndihmon klientin të miratojë kategorinë e rrezikut në punë, për të cilën kontraktori është i kualifikuar.
- Synoni një koordinim të shkëlqyeshëm reciprok.
- Mbikëqyrni aty ku është e nevojshme detyrat me rreziqe të larta.



HAPI 6 (PËRFUNDIMI I SIGURT I PUNËS)

Kontraktori duhet të kthejë vendin e punës në një gjendje të sigurt pas përfundimit të punës.

- Restaurimi i sigurt i vendit të punës.
- Asnjë mbetje e rrezikshme nuk duhet të jetë në vendin e punës.
- Mund të ketë implikime ekonomiko-ligjore mbi kontraktorin nëse vendi i punës nuk lihet i sigurt për klientin.
- Regjistrimi përfundimtar bëhet nga klienti vetëm kur kjo fazë të arrihet në mënyrë të sigurt nga kontraktori.





HAPI 7 (RAPORTI I PERFORMANCËS SË KONTRAKTORIT)

Raporti i performancës së SHS-së së kontraktorit formon një kredencial të rëndësishëm për punën në të ardhmen me të njëjtin klient dhe për industrinë në përgjithësi. Është përgatitur me ndihmën e personit të ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit, bazuar në ndërveprimin e ekipit të tyre me kontraktorin në faza të ndryshme. Ai përfshin pika pozitive/pro-aktive të SHS-së, regjistrime të incidenteve, veprime korrigjuese dhe parandaluese, mbetje, menaxhim të shëndetit dhe mirëqenies, pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe të klientit sipas kontratës, etj. Kjo fazë gjithashtu menaxhon:

- Një intervistë përfundimtare me kontraktorin
- Mësimet e nxjerra

Bazuar në raportin e performancës së kontraktorit, menaxheri i SHS-së së klientit do të këshillojë departamentin e kontratave, duke përzgjedhur kontraktorin që do të përfshihet në Listën Aktive ose Listën e Pritjes. Kontraktorët me një vlerësim aktiv do të preferohen për çdo punë në të ardhmen.



HAPI 8 (ARKIVIMI I DOKUMENTEVE)

I tërë dokumentacioni që lidhet me menaxhimin e kontraktorit duhet të arkivohet nga personi i ngarkuar për çështje të shëndetit dhe sigurisë nga ana e klientit sipas politikave të regjistrimeve të klientit. Ky dokumentacion duhet të ruhet për qëllime të auditimit.

Nëse të dhënat mbi SHS-në e klientit tregojnë se vlerësimi i SHS-së së kontraktorit ofertues është kryer brenda tre viteve të fundit dhe kategoria e rrezikut e kërkesës aktuale është e njëjtë ose më e vogël se ajo e vlerësimit të mëparshëm, atëherë vetëm Statistikat më të fundit të SH&S do të kërkohen nga kontraktori ofertues, nën supozimin që sistemi i menaxhimit të SHS-së së kontraktorit vazhdon të jetë i qëndrueshëm (dhe do t'i nënshtrohet verifikimeve të rastësishme).





AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar të Shtojcës. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive Sigurinë dhe Shëndetin dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE

Trajtojeni fuqinë punëtore të kontraktuar me të njëjtën vëmendje, drejtim dhe pritje sikurse punëtorët tuaj të drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë ata do të rreshtohen më mirë në linjën e qëllimeve të kompanisë suaj.

Mundohuni të shpjegoni se çfarë Sistemi të SHS-së keni, çfarë prisni prej tyre dhe si do t'i monitoroni dhe cilat janë pritjet tuaja të raportimit - jo vetëm për progresin e projektit, por edhe incidentet e SHS-së dhe veprimet korrigjuese/parandaluese të lidhura me to.

Një kontraktor i mbështetur dhe i monitoruar mirë jo vetëm që e bën projektin tuaj funksional por gjithashtu ruan reputacionin tuaj nëse asnjë lëndim apo incident nuk shfaqet.

Bazuar në pjesët e mëparshme dhe natyrën e punës së kontraktuar, mund të krijoni listën tuaj të kontrollit, për të zbatuar këtë udhëzues. Shtojca përmban një përmbledhje të asaj që kemi mësuar deri më tani.

Nëse keni nevojë për informacion të shtesë, ju lutemi kontaktoni Inspektoratin e Punës.



SHTOJCA: PËRMBLEDHJE

Tabela e mëposhtme ofron një kornizë të përgjithshme përmbledhëse të sistemit të menaxhimit të kontraktorëve, si një referencë e gatshme.

<p>HAPI 1 (VLERËSIMI PARAPRAK I KONTRAKTORIT): Klienti kërkon propozime nga ofertuesit. Emëron Personin e ngarkuar për SH&S të Klientit dhe personin përgjegjës për SHS-në e kontraktorit për të gjitha çështjet që ndërlidhen me SHS-në.</p>	<p>Kontraktorët ofertues i përgjigjen pyetësorit SH&S të klientit, dorëzojnë dokumente dhe certifikim siç kërkohet nga klienti. Klienti ndan kërkesat e SH&S për ofertuesit.</p>	<p>Vlerësimi tekniko-komercial i bërë nga Klienti. Vlerësimi i Shëndetit dhe Sigurisë i bërë nga Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit. Dështimi për të marrë rezultatin minimal në SHS e shkualifikon ofertuesin.</p>
<p>HAPI 2 (NDËRVEPRIMI, DHËNJË E KONTRATËS): Angazhimi fillestar i Personit të ngarkuar për SH&S të Klientit me Personin Përgjegjës të SHS të kontraktorit të zgjedhur.</p>	<p>Personi i ngarkuar për SHS i klientit ndan në detaje më të hollësishme politikat, procedurat, listat e kontrollit dhe kërkesat për trajnime lokale për SHS me Personin e caktuar për SH&S të kontraktorit, për të lehtësuar punën.</p>	<p>Nëse disa procedura/lista të kontrollit të SH&S të klientit nuk janë në dispozicion për punën, klienti do t'i kërkojë kontraktorit t'i zhvillojë ato dhe t'i miratojë ato për përdorim.</p>
<p>HAPI 3 (KONTROLLI I PLOTË PARAPRAK NGA KONTRAKTORI): kontraktori pajtohet me kërkesat e Klientit në lidhje me njerëzit, materialet, mjetet, pajisjet e tyre dhe paraqet raportin tek Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit</p>	<p>Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit shqyrton raportet e pajtueshmërisë së kontraktorit dhe i kërkon kontraktorit të adresojë çdo çështje që nuk përputhet. Kështu, burimet dhe kompetencat e kontraktorit janë të regjistruara.</p>	<p>Njerëzit: Certifikata të kompetencës dhe përvojës. Certifikata mjekësore për shëndetin, dhe mjetet dhe pajisjet të jenë të duhura për qëllimin.</p>
<p>HAPI 4 (KONTROLLI I RASTËSISHËM PARAPRAK I KLIENTIT): Personi përgjegjës për SHS-në e klientit cakton kontrole verifikimi në vend para se kontraktori të fillojë punën.</p>	<p>Kontrollet e rastësishme përfshijnë të gjitha burimet e kontraktorit me theks në artikujt me rrezik të lartë. Intervista të rastësishme të mbikëqyrësve kryesorë të kontraktorëve. Inspekton objektet e mirëqenies së kontraktuesit.</p>	<p>Prova e ngarkesës së vinçave; aftësia e makinave të saldimit, automjeteve, pajisjes radiografike, pajisjeve kryesore; kalibrimi i instrumenteve të testit të presionit. PMP kryesore (pajisjet e parandalimit të rënies; aparatet personale të frymëmarrjes etj.)</p>
<p>HAPI 5 (MONITORIMI I PUNËS NGA KLIENTI): Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit cakton mbikëqyrjen /monitorimin e rastësishëm të punës së kontraktuar deri në përfundimin e saj për të siguruar që standardet e SHS-së të mirëmbahen në terren.</p>	<p>Personi përgjegjës për SHS-në e kontraktorit paraqet raporte të rregullta të vetë-inspektimit/auditimit te Personi i ngarkuar për SHS i Klientit. Të gjitha incidentet dhe shmangiet e afërta raportohen tek Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit.</p>	<p>Personi përgjegjës për SHS-në e kontraktorit menjëherë informon personi përgjegjëspër SHS-në e Klientit nëse ka ndonjë ndryshim në personelin e kontraktuar dhe pajisjet kryesore. Klienti i shqyrton ato.</p>



<p><u>HAPI 6 (PËRFUNDIMI I SIGURT I PUNËS):</u> Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit siguron asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme dhe rikthimin e vendit në normalitet me Personin e caktuar për SHS-në e Kontraktorit</p>	<p>Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit zhvillon intervistën e përfundimtare me mbikëqyrësit kryesorë të kontraktorit dhe regjistron mësimet e marra.</p>	<p>Intervista e përfundimtare dhe performanca në lidhje me SHS-në e kontraktorit gjatë punës së tyre formon bazën e raportit të performancës SHS-së së kontraktorit.</p>
<p><u>HAPI 7 (RAPORTI I PERFORMANCËS SË KONTRAKTORIT):</u> Personi i ngarkuar për SH&S i Klientit e kompletton.</p>	<p>Raporti i performancës SH&S si Kontraktorit ndahet me Divizionet e Prokurimit/Kontratave të SHS-së së klientit.</p>	<p>Raporte të tilla janë të dobishme për rivlerësimin e kontraktorit për kontratat e ardhshme.</p>
<p><u>HAPI 8 (ARKIVIMI I DOKUMENTEVE):</u> Personi i ngarkuar i për SH&S i Klientit I menaxhon.</p>	<p>Menaxhmenti i lartë mund të rishikojë performancën (si shembull) të disa kontraktorëve të zgjedhur për punë.</p>	<p>Kjo siguron partneritet të vazhdueshëm me kontraktorë të mirë.</p>